

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24), dhe në lidhje me nenin 15 paragrafi (1) dhe paragrafi (6) dhe neni 29 të Ligjit për Media ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14 dhe 63/24), pika 7 dhe 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 të datës 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.03-2120/1 datë 29.04.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-2576/5 datë 31.05.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 25-të mbajtur në 31.05.2024, miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrje të masës - paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, për shkak të shkeljes së kryer të nenit 15 paragrafi (1) të Ligjit për Media (LM), të mënyrës që drejtuar Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) nuk ka paraqitur të dhëna për strukturën e pronësisë, redaktorin/redaktorët përgjegjës, burimet e financimit në vitin 2023, të ardhurat dhe shpenzimet totale të realizuara nga ofrimi i veprimtarisë në vitin 2023 dhe për dëgjueshmërinë mesatare në vitin 2023.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar dhe në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.03-2120/1 datë 29.04.2024, i cili është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET që SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, në afat prej 45 (dyzet e pesë) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi, të harmonizon punën e saj me dispozitat e LM.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Arsyetim

Agjencia, në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe nenit 29 të LM, është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të veprimtarisë së botuesve të mediave për sa i përket harmonizimit të punës së saj me detyrimet e neneve 6, 8, 14 dhe 15 të LM.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masën e paralajmërimit publik në rastet kur konstatohet mosrespektim, shkelje ose cënim i dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushtet dhe detyrimet, të përcaktuara me leje dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në nenin 29 paragrafi (2) të LM parashikohet se masat që Agjencia si organ rregullativ kompetent mund t'i ndërmarrë, të cilat janë përcaktuar në LSHMAAV, zbatohen në mënyrë të duhur dhe në rast të shkeljes së dispozitave të LM.

Në pajtim me nenin 15 paragrafi (1) të LM, transmetuesit janë të obliguar që deri më 31 mars të këtij viti në formular të veçantë përcaktuar nga ana e organit rregullator kompetent të dorëzojnë të dhëna për: strukturën e pronësisë, përkatësisht të dhënat për emrin dhe selinë e personit juridik ose emrin dhe vendbanimin e personat fizikë që zotërojnë aksione ose aksione tek botuesi i medias, me të dhëna për përqindjen e aksioneve ose pjesës së aksioneve që kanë fituar dhe datën e blerjes, të dhëna për redaktorin/redaktorët përgjegjës, të dhëna për burimet e financimit të transmetuesit në vitin paraardhës (reklama, sponsorizimi, shitjet e përmbajtjeve, shërbimet e ofruara palëve të treta, etj.), të dhënat për totalin e të ardhurave dhe shpenzimeve të transmetuesit në vitin paraprak nga ofrimi i veprimtarisë dhe të dhënat për shikueshmërinë dhe dëgjueshmërinë mesatare të transmetuesit në vitin e kaluar.

Në kuadër të kompetencave të saja ligjore, Agjencia përmes Sektorit për Planifikim Strategjik dhe të Drejtat e Autorit, më 29.04.2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative ndaj SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, nga ku konstatoi shkelje të nenit 15 paragrafi (1) të LM.

Nga mbikëqyrja e rregullt është konstatuar se SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar nuk e ka përmbushur obligimin e nenit 15 paragrafi (1) të LM, gjegjësisht në Agjenci nuk ka dorëzuar të dhëna për strukturën e pronësisë, redaktorin/redaktorët përgjegjës, burimet e financimit në vitin 2023, të ardhurat dhe shpenzimet totale të realizuara nga ofrimi i veprimtarisë në vitin 2023 dhe për dëgjueshmërinë mesatare në vitin 2023.

Shkelja nga pika 1 e këtij aktvendimi, është specifikuar dhe në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative me ark.nr. 03-2120/1 datë 29.04.2024, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi me Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, më 30.04.2024, dërgoi Shkresë me ark.nr.03-2120/2 datë 30.04.2024, me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.03-2120/1 datë 29.04.2024, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga ana e transmetuesit më 10.05.2024 Në afatin e parashikuar SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, nuk u deklarua për shkeljen e kryer të Ligjit. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur në 31.05.2024, pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim, konkludoi që ndaj SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar t'i shqiptoi masën-paralajmërim publik.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 15 paragrafi (1) dhe paragrafin (6) dhe neni 29 nga LM, pika 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Teksti i pastruar), Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.03-2120/1 datë 29.04. 2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-2576/5 datë 31.05.2024, për shkak të konstatimit për mos respektim të dispozitave të LM, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 25-të mbajtur më 31.05.2024, ka miratuar Aktvendim me të cilin publikisht paralajmërohet SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar dhe urdhërohet që në afat prej 45 (dyzet e pesë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LM. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër tij botuesi i medias (transmetuesi) ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.03-2120/1 datë 29.04.2024.